

## Iniciativë Trans-Atlantike për Përmbylljen e Konfliktit mes Kosovës dhe Serbis

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG) ka organizuar një seri diskutimesh gjatë vitit 2020 dhe 2021 për një grup ish-diplomatësh të lartë dhe akademikësh të SHBA-ve dhe BE-së, të cilët kanë shërbyer në Ballkanin Perëndimor ose kanë qenë të përfshirë në çështjet e rajonit. Qëllimi i diskutimeve ka qenë ofrimi i ideve dhe zhvillimi i rekomandimeve për një iniciativë trans-atlantike për të përmbyllur konfliktin shumë dekadësh mes Kosovës dhe Serbis. Rekomandimet e mëposhtme kanë pajtim të gjërë të pjesëmarrësve. Këto rekomandime nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e pjesëmarrësve individualisht, të CIG dhe të Fondit të Vëllezërve Rockefeller (RBF), i cili e ka mbështetur këtë iniciativën. CIG ka përgatitur raportin dhe merr përgjegjësinë për përmbajtjen e tij.

### Rekomandime

Konflikti mes Kosovës dhe Serbisë mbetet një kërcënim serioz për sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. SHBA-të dhe BE-ja duhet të shqyrtojnë marrjen e një iniciative të guximshme në mënyrë që ta zgjidhin këtë konflikt. Dialogu i Brukselit i mandatuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe i udhëhequr nga Bashkimi Evropian ka sjellë normalitet të konsiderueshëm në marrëdhëniet Kosovë-Serbi, por nuk ka arritur të përmbyllë konfliktin në tërësi. Një iniciativë e re trans-atlantike duhet të adresojë shkaqet rrënjësore të konfliktit, përfshirë statusin, dhe ta çojë këtë konflikt drejt fundit përmes një marrëveshjeje paqeje.

1. Megjithëse tash zgjidhja e mosmarrëveshjes Kosovë-Serbi nuk është prioritetet kryesore i politikës së jashtme të Uashingtonit dhe Brukselit, të dy kryeqytetet duhet të fillojnë konsultimet për të hartuar një strategji për zgjidhjen e konfliktit. Nëse marrëdhëniet mes BE-së dhe SHBA-ve arrijnë të rikuperohen nga traumat e administratës Trump, atëherë Ballkani Perëndimor, dhe konflikti Kosovë-Serbi në veçanti, duhet të jenë më shumë pikë uniteti sesa fërkimi. Është hapur një dritare mundësish për veprim.
2. BE-ja dhe SHBA-të duhet të bien dakord në fillim të vitit 2021 për një iniciativë të koordinuar. Koordinimi trans-atlantik është i rëndësishëm dhe thelbësor për të bërë përparim në një propozim konkret. Për më tepër, Brukseli dhe Uashingtoni duhet të zotohen që të mos marrin iniciativa të pavarura ose të bëjnë deklarata që do të befasonin ose minojnë palën tjetër.
3. Paralelisht me punën për një propozim zyrtar të paqes – Beogradi dhe Prishtina poashtu duhet të në proces të konsultimit – dialogu i Brukselit duhet të vazhdojë të përqendrohet kryesisht në masa praktike që do të lehtësonin jetën e përditshme si dhe përmirësonin prosperitetin e qytetarëve në Kosovë dhe Serbi.
4. Brukseli dhe Uashingtoni duhet të bien dakord t'i japin një peshë më të madhe – bashkërisht dhe individualisht – angazhimit të tyre me shoqërinë civile dhe organizatat joqeveritare në Serbi dhe Kosovë. Kjo duhet të përfshijë koordinimin e burimeve të tyre për të ndihmuar

shoqërinë civile të gjenerojë vrull dhe të ndërtojë mbështetje publike për një marrëveshje paqeje si dhe të promovojë sundimin e ligjit. Në këtë kontekst, gjithashtu duhet të ketë përpjekje për të forcuar komunitetin serb mjaft të margjinalizuar

5. Ekzistojnë një numër zgjidhjesh të përkohshme dhe të përhershme për të mundshme për konfliktin Kosovë-Serbi. Uashingtoni dhe Brukseli duhet të analizojnë të gjitha këto mundësi dhe të marrin masa në përputhje me rrethanat. Disa pjesëmarrës rekomanduan fokus të veçantë në të ashtuquajturit model ‘dy Gjermanitë’ si një marrëveshje të përkohshme, e cila do të përfshinte a) zgjidhjen e çështjeve praktike, b) anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare, dhe c) lejimin e Serbisë për të shënuar progres drejt anëtarësimit në BE pa e njohur Kosovën zyrtarisht. BE-ja dhe SHBA-të duhet të bien dakord mbi një pako ekonomike pas kësaj marrëveshjeje, si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë, dhe të angazhohen për t’i ndihmuar të dy shtetet me procesin e implementimit të marrëveshjes. Një pjesëmarrës poashtu sugjeroi krijimin e një zone të veçantë ekonomike që do të mbulonte zonën nga rajoni i Mitrovicës së Kosovës deri tek rajoni i Novi Pazarit të Serbisë.
6. SHBA-të dhe BE-ja duhet të ndërmarrin hapa për të lehtësuar marrëdhënie më normale dhe më kuptimplota mes Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, përfshirë organizatat shumëkombëshe, si dhe koordinimin me pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e njohin Kosovën me qëllim që të marrin zotimin e tyre për njohjen e Kosovës para ose së paku pas arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare – me ose pa njohje – mes Kosovës dhe Serbisë.

Është e domosdoshme që Uashingtoni dhe Brukseli të riafirmojnë zyrtarisht angazhimin e tyre për ta zgjidhur konfliktin Kosovë-Serbi brenda një afati të arsyeshëm kohor. Gjatë tryezave të CIG, pjesëmarrësit ishin të një mendimi që SHBA-të dhe BE-ja kanë kapacitetin dhe burimet e nevojshme për të hartuar një plan ambicioz paqeje, por që atë mund ta bëjnë vetëm duke punuar së bashku. Përndryshe, mungesa e një ambicieje trans-atlantike dhe angazhimi serioz do të prolongonte konfliktin, me pasoja për sigurinë e rajonit dhe për interesat trans-atlantike në Ballkanin Perëndimor.

## Historiku

Megjithëse dialogu i Brukselit ka adresuar një varg problemesh konkrete – përfshirë energjinë, telekomunikacionin, dokumentet e udhëtimit, regjistrin civil, pikat kufitare, doganat, integrimin e veriut, diplomat – ky proces nuk ka arritur të përmbyllë konfliktin midis Kosovës dhe Serbisë. Një marrëveshje përfundimtare e paqes edhe ashtu nuk ishte qëllimi i deklaruar i dialogut të Brukselit, por ishte të paktën një ambicie. Megjithëse BE udhëhoqi zyrtarisht dialogun, SHBA-të ofruan mbështetje të qëndrueshme diplomatike dhe ndihmuan në zbatimin e marrëveshjeve, rreth 80 përqind e të cilave janë zbatuar. Në vitin 2018, pas tetë vitesh bisedime, shefes së atëhershme të punëve të jashtme të BE-së, Federica Mogherini, thuhet se i është prezantuar një ide për shkëmbim të territoreve nga udhëheqësit e Serbisë dhe Kosovës dhe ajo rrjedhimisht braktisi procesin inkremental dhe synoi një marrëveshje të shpejtë, një “big bang”. SHBA-të dhe shumica e anëtarëve të BE-së nuk ishin entuziast për një ide të tillë. Iniciativa dështoi dhe dialogu i Brukselit ngeci.

Vitin e kaluar, në 2020, BE emëroi një të dërguar special, Miroslav Lajcak, me mandat për të ringjallur dialogun dhe për të ndërtuar një pako marrëveshjesh të çështjeve që përfundimisht do të bëheshin thelbi i një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të normalizimit. Në fund të vitit 2019, edhe

administrata Trump kishte caktuar të dërguarin e saj special, Richard Grenell, i cili udhëhoqi iniciativën e tij. Ishte hera e parë që partnerët trans-atlantikë po punonin ndaras mbi çështjen e Kosovës. Nuk kishte pothuajse fare koordinim midis dy të dërguarve. Qasja mjaft agresive e Grenell “fitoi” zemrat dhe mendjet e liderëve të caktuar në Kosovë dhe Serbi, dhe ofroi një “ceremoni” nënshkrimi në prani të presidentit amerikan. Grenell poashtu premtoi fonde të bollshme për zhvillimin ekonomik. Iniciativat e ndara dhe shpesh konfliktuale të BE-së dhe SHBA-ve reflektonin përçarjen e gjerë trans-atlantike që ishte zhvilluar gjatë administratës Trump për çështje që fillonin nga ndryshimi i klimës deri tek marrëveshja me Iranin.

Fundi i vitit 2020 dhe fillimi i vitit 2021 solli disa ndryshime thelbësore të lidërshpit në SHBA dhe në Kosovë. Joe Biden i Partisë Demokratike fitoi zgjedhjet presidenciale të Nëntorit 2020. Në Kosovë, Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit shënoi fitore të madhe në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të shkurtit 2021 dhe pritet të formojë një qeveri në fund të marsit. Qeveria e parë e Kurtit vitin e kaluar u rrëzua vetëm pas dy muajsh në detyrë pasi ish-kryeministri Kurti kategorikisht refuzoi angazhimin e tij në iniciativën e Grenell, duke kthyer si partnerët e tij qeverisës, ashtu edhe vetë Grenell kundër tij. Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila kishte qenë partneri qeverisës i Kurtit, më pas ndërtoi një tjetër koalicion qeverisës mjaft të brishtë, të mbështetur heshtur nga presidenti i atëhershëm Hashim Thaçi, dhe u angazhua në iniciativat e Brukselit dhe Uashingtonit. Por edhe qeveria e re u rrëzua pas gjashtë muajsh, kur Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kjo qeveri nuk ishte zgjedhur me votat e mjaftueshme të vlefshme në parlament.

Serbia ka qenë bashkëpunuese me Uashingtonin dhe Brukselin, duke mos shfaqur preferenca për njërin apo tjetrin. Sidoqoftë, me ndryshimet në administratën e SHBA-ve, nuk pritet që Serbia do të respektojë të gjitha pikat e Marrëveshjes së Uashingtonit, siç është zhvendosja e ambasadës së saj në Izrael nga Tel Aviv në Jeruzalem. Fati i gjithë Marrëveshjes së Uashingtonit është i panjohur për momentin. As Kosova nuk pritet të respektojë të gjitha pikat. Në shkurt 2020, Presidenti Biden u dërgoi letra Presidentit të Serbisë Aleksandar Vuçiç dhe Presidentes së Përkohshme të Kosovës Vjosa Osmani, duke i uruar për përvjetorët përkatës të pavarësisë së vendeve të tyre, me ç’rast theksoi se një marrëveshje paqeje e bazuar në "njohjen e ndërsjellë" është zgjidhja që mbështetet nga SHBA-të. Ndërsa pranon që presioni ndërkombëtar ndaj Beogradit mund të rritet, Presidenti Vuçiç thotë se njohja e Kosovës është e padiskutueshme. Kryeministri i i ardhshëm i Kosovës Albin Kurti, nga ana tjetër, argumenton se një zgjidhje pa njohje nuk është zgjidhje. Në ndërkohë, BE është gati të zgjasë mandatin e të dërguarit të saj për 17 muaj të tjerë me detyrën e pandryshuar të ndërtimit të elementeve të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse. Administrata e re e SHBA-ve ka sinjalizuar se do të mbështesë procesin e BE-së dhe nuk planifikon të risjellë iniciativën e Grenell.

Është e qartë që BE-ja dhe SHBA-të synojnë të rivendosin bashkëpunimin mbi mosmarrëveshjen Kosovë-Serbi, por ajo që nuk është e qartë është se sa të përkushtuara planifikojnë të jenë për të kërkuar një zgjidhje të përhershme. Mbetet të shihet nëse synimi është që thjesht të drejtojnë një proces për të menaxhuar konfliktin Kosovë-Serbi, apo të thurin një plan ambicioz të paqes për zgjidhjen e konfliktit.

## **Diskutim i zgjeruar**

- 1. Negociatat Kosovë-Serbi të inkuadrohen në partneritetin e ri trans-atlantik.** Megjithëse çështja Kosovë-Serbi nuk pritet të jetë prioritet kryesor për administratën e Biden, megjithatë do të jetë një çështje e politikës së jashtme të SHBA-ve, siç tregohet në letrat që Presidenti Biden u dërgoi presidentëve të Serbisë dhe Kosovës në shkurt. Çështja e Kosovës duhet të përfshihet në pakon trans-atlantike të prioritetëve, për të cilat BE-ja dhe SHBA-të po punojnë tani. Duke qenë se siguria në rajon është një interes trans-atlantik, SHBA-të dhe BE-ja duhet të formulojnë një strategji të përbashkët për të adresuar të gjitha çështjet e hapura në Ballkanin Perëndimor. Si BE-ja, ashtu edhe SHBA-të kanë burimet e nevojshme për të zgjidhur mosmarrëveshjet e pazgjidhura të rajonit dhe gradualisht ta integrojnë këtë rajon në BE dhe NATO.
- 2. Në fillim të vitit 2021, të koordinohet një proces i drejtuar bashkërisht.** SHBA-të dhe BE-ja duhet të bien dakord mbi një proces të përbashkët negociimi për Kosovën dhe Serbinë me qëllime të qarta, një ekip të vetëm dhe një plan zbatimi. Udhëheqja e SHBA-ve është kritike për një të shënuar progres, kështu që procesi preferohet të bashkë-drejtohet, por edhe nëse drejtohet nga BE-ja, SHBA-të duhet të kenë një rol kyç në të. Diplomatët amerikanë dhe evropianë duhet të mbledhen në fillim të vitit 2021 për të hartuar një proces të tillë negociimi. Parimi kryesor i bashkëpunimit duhet të jetë “pa befasi”; që do të thotë se asnjëra palë nuk duhet të ndërmarrë iniciativa ose të bëjë deklarata publike pa u konsultuar me tjetrën.
- 3. Fokusi të jetë paralel me masa praktike dhe me një zgjidhje gjithëpërfshirëse.** Presidenti Vuçiq ka shumë të ngjarë të mos ndërmarrë hapa për të zgjidhur statusin përpara zgjedhjeve të ardhshme presidenciale serbe në 2022, ku ka shumë gjasa të rizgjidhet. Kryeministri i ardhshëm i Kosovës Kurti ka të ngjarë të përqendrohet gjithashtu në adresimin e disa çështjeve të brendshme, të cilat ai premtoi se do ti trajtonte me prioritet gjatë fushatës së tij, përpara se të angazhohet seriozisht në negociata me Beogradin. Asnjëra nga palët nuk do të jetë e gatshme për një zgjidhje madhore gjatë vitit 2021. Prandaj, në vend se të ofrojnë menjëherë një propozim të ri për një zgjidhje gjithëpërfshirëse, BE-ja dhe SHBA-të duhet të vazhdojnë dialogun aktual me qëllime të menjëhershme më pak ambicioze për vitin 2021. Procesi duhet të dëshmojë përpjekje për "normalizimin" e idesë së negociatave dhe kompromisit, të riformulojnë narrativat e brendshme, si dhe të mundësojë mbështetje publike për një të ardhme evropiane duke u përqendruar në masa që rrisin shkëmbimin e lirë ekonomik, lirinë e lëvizjes dhe hapa të tjerë që do të përmirësonin jetën e përditshme dhe ndërtimin e besimit tek qytetarët. Sidoqoftë, paralelisht me këto përpjekje, SHBA-të dhe BE-ja, në konsultim me Beogradin dhe Prishtinën, duhet të fillojnë të mendojnë dhe të punojnë për një zgjidhje të përhershme që do të mund të shpalojë në tryezën e negociatave në gjysmën e dytë të 2022.
- 4. Të ketë angazhim të shoqërisë civile në ndërtimin e mbështetjes publike për paqen dhe promovimin e sundimit të ligjit.** Një mesazh i qartë trans-atlantik për luftimin e korrupsionit, pro sistemeve të pavarura të drejtësisë dhe medias së lirë duhet t'u drejtohet liderëve politikë dhe qytetarëve të Serbisë dhe Kosovës. Përderisa roli i udhëheqësve politikë është thelbësor në zgjidhjen e konfliktit dhe zbatimin e reformave, ekzistenca e një shoqërie të fortë civile është thelbësore për t'i bërë këto procese të qëndrueshme dhe të pakthyeshme. SHBA-të dhe BE-ja duhet të angazhojnë ekspertizën dhe burimet e tyre për çështjet e qeverisjes së mirë dhe të angazhohen më aktivisht me zonat elektorale jo-qeveritare në Serbi dhe Kosovë. Poashtu, SHBA-të dhe BE-ja duhet të inkurajojnë zonat elektorale të Kosovës dhe Serbisë që të kërkojnë

më shumë llogaridhënie nga qeveritë e tyre. Përfshirja e shoqërisë civile - organizatave joqeveritare, medias së pavarur, akademisë dhe grupeve të interesit - në një debat jopartiak do të mund të kontribuonte në uljen e ndjeshmërisë së publikut ndaj politikave partiake dhe dezinformimit, si dhe do të ndihmonte në thyerjen e monopolit të politikanëve mbi sferën publike. Puna me shoqërinë civile duhet të përfshijë çështjen e Dialogut, por jo të përqendrohet vetëm në të. Ky proces duhet të promovojë mbështetjen e publikut për një marrëveshje paqësore midis Kosovës dhe Serbisë por gjithashtu të përqendrohet në promovimin e medias së pavarur dhe luftimit të korrupsionit. Vetë Presidenti Biden e ka listuar luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar në SHBA dhe përtej kufijve si prioritet kryesor. SHBA-të dhe BE-na duhet të rreshtojnë prioritetet e tyre në rajon aq sa munden me prioritetet e brendshme të Serbisë dhe Kosovës, veçanërisht duke i ndihmuar këto dy shtete të forcojnë rendin e ligjit dhe të luftojnë korrupsionin.

5. **Të përgatitet një propozim i ri gjithëpërfshirës.** Rregullat më themelore në negociata janë “të mos shkaktohen dëme” dhe “të mos harxhohet kohë kot duke qëlluar një kalë të ngordhur”. Një folës favorizoi opsionin e zgjidhjes së ashtuquajtur “big bang” përmes një marrëveshjeje me shkëmbime terriroresh. Shumica e folësve nuk u pajtuan, duke argumentuar se ndryshimet e kufijve "krijojnë më shumë probleme sesa zgjidhin". Si një zgjidhje alternative të përkohshme, disa pjesëmarrës sugjeruan modelin ‘dy Gjermanitë’, me anë të së cilës zgjidhen një numër problemesh praktike, si p.sh. Kosova anëtarësohet në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare, kurse Serbia shënon progres drejt integritimit në BE pa e njohur Kosovë ligjërisht. Me fjalë të tjera, një zgjidhje e tillë do të anashkalonte çështjen e njohjes, por mundëson marrëdhënie më të mira midis Prishtinës dhe Beogradit. Sidoqoftë, një pjesëmarrës tha se modeli gjerman nuk është i mjaftueshëm për Serbinë. “Unë shoh atë që do të përfitonte Kosova nga një model i tillë, por nuk shoh shumë përfitime për Serbinë; do të mbyllej Kapitulli 35 por kjo nuk mjafton.” Disa folës të tjerë argumentuan se lejimi i Serbisë për të lëvizur drejt pranimit në BE pa njohur Kosovën është një përfitim i rëndësishëm për Serbinë. Për të “ëmbëlsuar” marrëveshjen, një folës tjetër sugjeroi që marrëveshja mund të përfshijë azhurnimin e statusit të kishave serbe dhe të drejtat për komunitetin serb në Kosovë. Një folës ishte optimist se "me ndërmjetësues të mirë", palët mund të arrijnë një marrëveshje për "dy Gjermanitë" brenda dy vjetësh. Sidoqoftë, BE-ja dhe SHBA-të do të duhej ta bënin të qartë se kjo është vetëm një zgjidhje e përkohshme. Sipas marrëveshjes, njohja e Serbisë për Kosovën nuk është e nevojshme që ajo të hapë kapituj të rinj me BE-në, por njohja do të mbetet një "kusht i panegociueshëm" për anëtarësimin zyrtar në BE.
6. **Të lehtësohet „integrimi ndërkombëtar“ i Kosovës.** SHBA-të mund të flasin njëzëri, por BE-ja nuk mundet. Ka një problem të brendshëm; pesë nga anëtarët e saj - Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja - nuk e njohin Kosovën. Pozicioni neutral i statusit të BE-së dhe shefit të saj të politikës së jashtme, dhe të dërguarit special të dialogut, përkatësisht nga Spanja dhe Sllovakia si dy "mosnjohës" të Kosovës, janë faktorë që po dëmtojnë besueshmërinë e BE-së në Kosovë. Për më tepër, BE-ja ia mohoi Kosovës liberalizimin e vizave edhe pasi Kosova ratifikoi marrëveshjen e shënimit të kufirit me Malin e Zi, e konsideruar si “pengesa e fundit” nga vetë BE-ja. Anëtarët kryesorë të SHBA-ve dhe BE-së dhe njohësit e parë të Kosovës, të tilla si Gjermania dhe Franca, duhet të punojnë më shumë me “pesë mosnjohësit” për t'i sjellë ata më pranë njohjes. Njohja kolektive e BE-së për Kosovën do t'i bënte gjërat shumë më të lehta. SHBA-të dhe vendet kryesore anëtare të BE-së

duhet gjithashtu të ndihmojnë Kosovën të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare si UNESCO dhe Interpol.

## **Pikat shtesë të diskutimit**

Disa folës argumentuan se rritja e ndikimit të huaj në rajon në kurriz të interesave të SHBA-ve dhe BE-së është shqetësuese. Duke përfituar nga “neglizhenca” e SHBA-ve dhe BE-së për rajonin, sfiduesit trans-atlantikë kanë bërë ndërhyrje të rëndësishme politike dhe ekonomike. Ndikimi i Ruisë, Kinës dhe Turqisë në politikën dhe ekonominë e Ballkanit Perëndimor është i dukshëm dhe sa vazhdon e rritet. Duke qenë vetë shtete autoritare, iniciativa e “rripave dhe rrugëve” e Kinës në Serbi dhe privatizimi i Ruisë dhe Turqisë i sektorëve kryesorë të sigurisë kombëtare në Serbi dhe Kosovë - të tilla si energjia dhe telekomunikacioni - çimentojnë interesat e tyre, mbështesin liderët gjysmë-autoritarë të rajonit, dëmtojnë progresin demokratik, dhe kërcënojnë interesat trans-atlantike në rajon. Zgjidhja e konflikteve të ngelura hapur në Ballkan dhe një tranzicion i pakthyesëm demokratik në rajon janë interesa ballkanike dhe transatlantike.

Gjatë tryezave u adresua edhe roli i Ruisë në negociatat Kosovë-Serbi. Nëse modeli gjerman përfshin anëtarësimin e Kosovës në OKB, atëherë kërkohet miratimi i Ruisë. Rusia nuk është përfshirë në dialogun e Brukselit. Por Rusia ka qenë pjesëmarrëse aktive në përpjekjet diplomatike të vitit 1999 ku mbështeti Rezolutën 1244 të OKB-së, megjithëse kishte kundërshtuar ndërhyrjen e NATO-s. Ajo poashtu mori pjesë në negociatat e Vjenës në vitin 2007, megjithëse nuk mbështeste rezultatin e negociatave, por as nuk bëri shumë për të dëmtuar procesin. Nuk është e qartë se sa ndikim ka Rusia mbi udhëheqjen e Serbisë. Analistët janë të ndarë për këtë çështje: disa thonë se Presidenti serb Vuçiç nuk mund të pajtohet me një marrëveshje me Kosovën pa bekimin e Moskës, ndërsa të tjerët thonë se nëse Vuçiç do të duhej të vendoste mes Perëndimit dhe Ruisë, ai do të vendoste për të parën. Shumica e pjesëmarrësve nuk e mbështetën angazhimin e drejtpërdrejtë të Ruisë në negociatat midis Beogradit dhe Prishtinës, duke argumentuar se presidenti rus Vladimir Putin do të përdorte vendin e tij në tryezë thjesht për të çakorduar procesin. Por ata nuk e mohuan ndikimin e Moskës në Beograd dhe ranë dakord që Rusia duhet të integrohet disi në Dialog, por pa i dhënë një fjalë të drejtpërdrejtë në proces.

Një folës propozoi braktisjen totale të modelit të dialogut të Brukselit, duke argumentuar se ai i jep Beogradit perparësi. Të gjitha palët duket se po i “përgjërohen” Serbisë të njohë Kosovën. Beogradi nuk duhet të lejohet të manipulojë në mënyrë të pacaktuar peshën e presionit për njohjen e Kosovës. "Presioni i SHBA-ve dhe BE-së është shumë më i fortë dhe duhet të përdoret në një proces të ri." Duke treguar dobësinë e BE-së, një tjetër folës tha se BE-ja ka rezultuar e paafte për të siguruar edhe zbatimin e marrëveshjeve që ajo vetë ka ndërmjetësuar. Prandaj disa folës konstatuan se SHBA-të duhet të bashkë-udhëheqin procesin e negociatave së bashku me BE-në dhe se procesi i ri duhet të ketë një afat kohor për arritjen e një marrëveshjeje. Negociatat pa ndonjë cak përfundimtar duhet të braktisen.

Prishtina dhe Beogradi kanë dëshmuar se mund të arrijnë kompromis - rreth 30 marrëveshje janë arritur brenda Dialogut të Brukselit - përderisa interesat e tyre kryqëzohen dhe përderisa SHBA-të dhe BE-ja koordinojnë përpjekjet dhe fuqitë e tyre. Konsideruar nga popullata e Kosovës si “themelues” i shtetit të Kosovës, SHBA-të kanë ndikim të pashembullt në Kosovë dhe mund ta përdorin atë për t'i bërë udhëheqësit e Kosovës të bien dakord për një marrëveshje të përkohshme,

edhe pa njohje ligjore, si dhe t'i bindë ata të bëjnë kompromise për një zgjidhje të përhershme. Nga ana tjetër, BE-ja, me 'karrotën' e saj të anëtarësimit, ka më shumë ndikim mbi Serbinë se SHBA-të. Një kombinim efektiv i fuqisë dhe përpjekjeve SHBA-BE do të mund të çonte në një rezultat të suksesshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Pjesëmarrësit arritën në përfundimin se SHBA-të dhe BE-ja kanë kapacitetin dhe burimet e nevojshme për të sjellë paqe të përhershme midis Kosovës dhe Serbisë, por kjo mund të arrihet vetëm përmes veprimeve të përbashkëta dhe të guximshme.

# Pjesëmarrësit

*Renditur sipas alfabetit në anglisht*

**Gordon Bardos**, President, SEERECON

**Jennifer Brush**, Ish-Drejtoreshë, Zyra për Evropën Jugore-Qendrore, Departamenti i Shtetit, SHBA; Ish-Zëvendës-Përfaqësuese Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë

**Steven Burg**, Profesor, Universiteti Brandeis

**Robert Cooper**, Ish-këshilltar, Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm

**Thomas Countryman**, Ish-ndihmës sekretar, Departamenti i Shtetit, SHBA

**Greg Delawie**, Ish-Ambasador i SHBA-ve në Kosovë

**Shpetim Gashi**, Nën-president, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

**Sebastian Gricourt**, Drejtor, Observatori Ballkanik, Fondacioni Jean Jaures; Këshilltar për Çështje Ndërkombëtare dhe të Mbrojtjes, Partia Socialiste

**Stephen Heintz**, President, Fondi i Vëllezërve Rockefeller

**Jean-Hubert Lebet**, Ish-Ambasador i Zvicrës në Kosovë

**Pierre Mirel**, Drejtor i Përgjithshëm Nderi, Komisioni Evropian

**Cameron Munter**, Ish-Ambasador i SHBA-ve në Serbi

**Igor Novakovic**, Bashkëpunëtor në Serbi, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

**Alex Roinishvili Grigorev**, President, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

**Joachim Ruecker**, Ish-Shef i Misionit të OKB-së dhe Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë

**Kyle Scott**, Ish-Ambasador i SHBA-ve në Serbi

**Christoph Spaeti**, Zyrtar i Programit për Kaukazin dhe Ballkanin Perëndimor, Departamenti Federal i Zvicrës për Punë të Jashtme

**Karsten Voigt**, Ish Koordinator i Marrëdhënieve Gjermani-Amerikë Veriore, Zyra Gjermane për Punë të Jashtme; Ish-Drejtor, Asambleja Parlamentare e NATO-s

**Mia Vukojevic**, Drejtoreshë Programi, Ballkani Perëndimor, Fondi i Vëllezërve Rockefeller

**Hoyt Yee**, Ish-Zëvendës Ndhmës Sekretar, Departamenti i Shtetit, SHBA

**Samuel Zbogor**, Ish-Ministër i Jashtëm i Sllovenisë; Ish-Shef i Zyrës së BE-së dhe Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë